

**VENDIM**  
**Nr. 651, datë 3.10.2019**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 295, DATË 10.5.2019, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR  
PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË  
PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË  
DYTË OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË  
KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR  
VITIN AKADEMIK", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 74, pika 1, e 76, pika 2, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 7, të vendimit nr. 295, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen pikat 7/1 dhe 7/2, me këtë përmbajtje:

"7/1. Kandidatët, që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve në fushën e artit dhe të sportit, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare, të parashikuar në pikat 2 e 5, të këtij vendimi.

7/2. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, që aplikojnë për t'u pranuar në programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare, të parashikuar në pikat 2 e 5, të këtij vendimi."

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**